



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.4, datë 30/05/2023

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS “PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, SUBJEKTIT “ANTEA CEMENT” SH.A

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale (prodhim i çimentos) me Nr.serie:0011, miratuar nga KBU Ishëm-Erzen me Vendim Nr.10, datë 12.07.2018, subjektit “Antea Cement” sh.a, me vendndodhje, Borizanë, Bashkia Fushë Krujë, Qarku Durrës, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 477507.5

- $Y=4600721.2$
- $Z=222$ m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes}= 5.5$ l/s
- Sasia e ujit në përdorim : $Q=4,6$ l/s
- Qëllimi i përdorimit : Ujë teknologjik
- Shkarkimi i ujërave të përdorur : Do të bëhet përpunim paraprak në reaktor të posaçëm, përpara derdhjes së tyre në trupin ujqor.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

